

**PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES
KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)
MBLEDHJA XXIX**

“Sfidat e NVM-ve: Tranzicioni drejt burimeve alternative të energjisë”

Tiranë, 31 janar 2023, 11:30 – 13:00

Mbledhja u drejtua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI. Në mbledhje morën pjesë 13 anëtarë të KI dhe mbi 40 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

Hapja e Mbledhjes nga Ministria Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI

Në fjalën e saj hyrëse, Ministria Ibrahimaj theksoi se energjia ka qenë kryefjala e diskutimeve në nivel qeveritar dhe atë të biznesit në dy vitet e fundit. Edhe pse kjo periudhë nuk ka qenë e thjeshtë për bizneset, ekonomia e vendit ka treguar rezistencë dhe fleksibilitet, në një kohë që qeveria ka reaguar dhe ka marrë masat e duhura. Tranzicioni i gjelbër dhe investimet në energjitë e rinovueshme, në të gjithë nivelet e bizneseve, është një punë dhe sfidë e përbashkët dhe shprehu gatishmërinë për të ndërmarrë iniciativat e duhura në këtë drejtim, në bashkëpunim me biznesin. Ministria pohoi se Shqipëria është një vend që energjinë elektrike e prodhon nga burime të rinovueshme dhe theksoi faktin se qeveria (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) ka marrë masa në funksion të përmbushjes së objektivit për të diversifikuar ofertën e energjisë elektrike. Në një kohë që bizneset shqiptare e kanë të bazuar prodhimin e tyre kryesisht në energjinë elektrike, Ministria Ibrahimaj përmendi faktin se qeveria ka subvencionuar dhe do të vijojë të subvencionojë çmimin e energjisë elektrike për pjesën më të madhe të bizneseve.

Prezantimi i analizës së Sekretariatit

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, informoi se analiza e Sekretariatit ka si qëllim kryesor stimulimin e dialogut mbi sfidat e NVM-ve për investime në burime alternative të energjisë, me fokus a) cilësinë e furnizimit me energji dhe faktorët që ndikojnë në vendimmarrjen për investime alternative dhe b) ndërgjegjësimi për aksesin në financë. Studimi thekson nevojën për prioritetizimin e ndërhyrjeve për të adresuar pasiguritë e sipërmarrësve në kuadër të dinamikës së tregut të energjisë dhe Axhendës së Gjelbër.

Në mbyllje, znj. Leka falenderoi partnerët: Auleda Vlorë, Dhoma Tregtisë dhe Industrisë Durrës, Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë, Dhomen Ekonomike të Gruas dhe Bashkinë Korçë për mbështetjen e ofruar për realizimin me sukses të takimeve me biznese.

Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Z. Christoph Denk, BERZH, përgëzoi Ministren Ibrahimaj, anëtarët e Këshillit të Investimeve dhe Sekretariatit për përfshirjen e tyre në këtë platformë të rëndësishme të dialogut publik-privat dhe falënderoi donatorin e Këshillit të Investimeve, Qeverinë Zvicerane që mbështet këtë forum. Tema e sotme është shumë e rëndësishme për të gjitha vendet dhe bizneset në sfidën e dyfishtë të sigurisë energjetike dhe tranzicionit në energjinë e gjelbër—të bashkohen në kuadrin e energjisë së rinovueshme, ku Shqipëria ka një rol të veçantë. Sfida kryesore është diversifikimi i energjisë nga ajo hidrocentrale në forma të tjera të energjisë së rinovueshme si era dhe dielli, ku Shqipëria ka

bërë hapa të mëdhenj përpara, veçanërisht për sa i përket ankandëve të suksesshme për energjinë e rinovueshme që kanë fituar vëmendje të gjerë në rajon dhe në mesin e investitorëve. Hapa të tjerë të rëndësishëm janë të nevojshëm për zhvillimin e mëtejshëm të tregut, duke përfshirë këtu për shembull bursën e energjisë, si dhe adresimin e sfidave që dalin në gjetjet e identifikuara nga dokumenti teknik i Sekretariatit—për të ofruar në mënyrë efektive shërbim të besueshëm dhe cilësor të energjisë elektrike, i cili është thelbësor për NVM-të. BERZH po e mbështet sektorin përmes financimit, por edhe përmes këshillimit dhe angazhimit në nivel politikash në reformat e sektorit, ndërsa mbështet NVM-të përmes bankave partnere dhe i këshillon ato përmes Programit “Këshilla për Biznesin e Vogël” (BERZH), duke trajtuar edhe më shumë temën e trajnimeve dhe aftësive që janë thelbësore për zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe për tranzicionin e ekonomisë së gjelbër.

Znj. Klodiana Ajazi, Dhoma Ekonomike e Gruas, falenderoi për prioritetin që i jepet çështjes gjinore dhe më tej u shpreh se rekomandimet e tyre përfaqësojnë si biznesin e madh, ashtu edhe atë të vogël, të cili i është dhënë një vëmendje e veçantë dhe ka plotësuar edhe anketën e dërguar nga Sekretariati. Rekomandimet kryesore të DHEG janë:

1. Përpos strategjive dhe miratimit të ligjit, nevojitet ngritja e grupeve të punës dhe një qasje proaktive mes institucioneve dhe dhomave të biznesit për të mundësuar informimin, jo vetëm mbi incentivat fiskale të ofruar në kuadër të energjisë, por edhe për termat teknike dhe zbatimit praktik të tyre. NVM-të, edhe pse mund të kenë burime financiare për të investuar dhe e kanë të nevojshme të investojnë, në një pjesë të konsiderueshme nuk e kuptojnë këtë lloj investimi dhe u mungon modeli i duhur në këtë drejtim.
2. Hartimi i programeve të përshtatura me karakteristika sektoriale duke qenë se sektorë të ndryshëm kanë sfida të ndryshme.
3. Ngritja e kapaciteteve të strukturave zbatuese të ligjeve/strategjive apo edhe rekomandimeve të dhëna, pasi pavarësisht se kemi ligje të mira në çalojmë në zbatim të tyre. Për shembull, efica e energjisë lidhet direkt me standardin dhe cilësinë e ndërtimit në Shqipëri. Pavarësisht kërkesave ligjore dhe auditimeve të kryera (ligjet i përfshijnë këto kërkesa dhe standarde), ndërtesat tona të reja apo të vjetra, nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj mbi efica e energjisë. Këtu ka vend për një bashkëpunim më të mirë mes institucioneve/dhomave/bizneseve në raport me monitorimin dhe kontrollin.

Ndërkohë, një sfidë e biznesit të madh, e cila mbase më shumë duhet adresuar me MIE. Prodhuesit dhe vetë-prodhuesit kanë një pyetje: A e përballon sot rrjeti i shpërndarjes kërkesën aktuale për të investuar në burime të rinovueshme?

Z. Enea Karakaçi, MIE, u shpreh se gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në studimin e Sekretariatit janë mjaft interesante dhe një pjesë e tyre janë të ditura nga MIE. Gjatë vitit të kaluar, MIE ka zhvilluar një sërë tavolinash konsultuese me shoqata/dhoma/biznese, ndërsa me Dhomen e Tiranës ka pasur edhe një grup pune në lidhje me energjinë. Ligji për burimet e rinovueshme është në kuvend dhe në atë draft-ligj janë përfshirë një sërë nga rekomandimet e përmendura këtu, p.sh. netimi vjetor, komuniteti i energjisë, etj. Nga ana tjetër ka dhe elementë që duhet të merren në konsideratë nga ana e biznesit dhe dhomave. Është e qartë se buxheti i shtetit nuk mundet të suportojë në pafundësi çmimin e energjisë për biznesin. Biznesi i lidhur në 35kW, pavarësisht se ka çmime të larta, sërisht i ka në nivele më të ulta se tregu duke qenë se ende furnizohen nga kompania KESH.

Një lajm i mirë: Shoqëria ALPEX (Bursa Shqiptare e Energjisë) që prej muajit nëntorit 2022 ka filluar trajnimet për operatorët që duan të jenë pjesë e saj. Ftohen të gjitha palët e interesuara të bëhen pjesë e këtyre trajnimeve pasi sipas parashikimeve bursa do të jetë funksionale brenda muajit prill 2023. Në lidhje me vetë-prodhimin, nuk përmendet shpesh fakti që në 2019 ka pasur 0 MW

kapacitet të instaluar vetëprodhues, ndërsa në fund të vitit 2020 ka shkuar në mbi 100MW, një shifër e lartë që vjen si rrjedhojë e incentivave shtetërore. Pavarësisht problematikave me procedurat, bashkitë, lejet e ndërtimit, etj., rritja e çmimit dhe lehtësimi i procedurave ka bërë të shtohet interesi për këtë teknologji dhe në 2023 ky kapacitet pritet të dyfishohet. Në thirrjen e fundit për WBIF, MIE do të vazhdojë me masat për diversifikimin e energjive të rinovueshme. Do të mbahet një thirrje për një investim 50MW që kompania KESH do të investojë në Belsh. Gjithashtu, nëpërmjet WBIF është bërë një aplikim përse i përket masave të efikasitetit të energjisë ku MIE ka kërkuar një fond deri 20 milionë Euro dhe pritet të shpallet fituesi. Ky fond do të shkojë për vazhdimësinë e masave të marra deri tani, në fotovoltaike, ujin e ngrohtë për familjarët, por mund të shtrihet edhe më gjerë në masat financuese për bizneset.

Në fund, shprehu interesimin për të diskutuar me subjektet në këtë mbledhje edhe një çështje: BERZH ka të dedikuar një fond së bashku me BE tek bankat e nivelit të dytë për financim direkt në efikasitet energjie, ku 10%-20% është grant, por Shqipëria ka nivelin e penetrimit më të ulët në rajon në këtë drejtim dhe kjo duhet parë edhe nga ana e subjekteve për të kuptuar përse ndodh kështu.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh për nevojën për informim të biznesit—një gjetje edhe e anketës së Sekretariatit—dhe në këtë drejtim dhomat e tregtisë janë bashkëpunëtori më i mirë. Ekzistenca e një portali që të përmbledhë të gjithë informacionin ekzistues është e pamjaftueshme pasi ka shumë biznese të vogla e të mesme të cilat nuk do ta aksesonin këtë portal. Është e rëndësishme që dhomat e tregtisë të bashkëpunojnë sa i takon informimit dhe konsultimit publik. Sikurse rezultoi edhe në mbledhjen e dedikuar të KI gjatë vitit të kaluar për konsultimin publik, portali online i konsultimit nuk përdoret. Forma më e preferuar rezultoi se ishte tryeza e rrumbullakët e cila ka kufizime dhe nuk mundëson gjithëpërfshirje. Për këtë arsye, duhet të punohet më shumë përse i përket nivelit të bashkëpunimit dhe në vijim të kësaj mbledhje Sekretariati mund të vazhdojë të marrë propozime në këtë drejtim.

Z. Nesti Tarusha, Fix PRO sh.p.k., u shpreh se sektori i prodhimit është sektori më i prekur nga kriza energjitike dhe kriza globale në përgjithësi. Si pasojë, bizneset janë të detyruara të gjejnë zgjidhjen për të përballuar këto kriza. Së pari, kompani Fix PRO mori vendimin për të investuar në gusht të vitit 2021 dhe në tetor 2021 u vu në punë impianti i prodhimit të energjisë 0.5MW (brenda limitit të lejuar), i cili sot mbulon 60% - 65% të konsumit për të cilin kompania ka nevojë. Së dyti, kompania funksionon në rregjim kondicionimi dhe kapacitet frigoriferik dhe për këtë arsye ka ndërhyrë në sistemin e ftohjes, ku shfrytëzohet e gjithë energjia e kompresorëve nga të cilët përfitohet i gjithë uji sanitar. Së treti, kompania ka ndërhyrë në të gjithë sistemin e ndriçimit duke i zëvendësuar ato me ndriçim LED dhe ndërhyrja e fundit ka qënë tek shfrytëzimi i mbetjeve të cilët kalojnë në një proces përpunimi për të siguruar ngrohjen e fabrikës.

Sugjerimet e kompanisë në drejtim të qeverisë janë:

1. *Më fleksibël në marrjen e vendimeve të shpejta.* Kompania mori vendimin që investimin ta kryente me fondet e veta duke qënë se sipas përlogaritjeve do t'i duhej deri 1 vit e gjysëm që të aprovohej fondi nëse do të aplikonte në fondet e IPARD, për shembull. Pra reagimi nga shteti duhet të jetë më i shpejtë duke qënë se biznesi ecën shumë më shpejt.
2. *Rishikimi i kapacitetit instalues.* 0.5MW kapacitet instalues është i ulët për shumicën e biznesit duke qënë se nevojat janë më të mëdha dhe për këtë arsye do të vlerësohej mjaft rishikimi i tij.

Z. Luis Ndreka, Lufra, u shpreh mbi problematikat e mëposhtme:

1. *Limiti i instalimit* – Si konsumatorë të mëdhenj, limiti 0.5 MW zëvendëson deri në 15%-20% të konsumit prej rreth 350 MW në muaj. Duke mirëkuptuar vështirësitë e rrejtit, sugjeroi një

ndryshim të limitit bazuar në një formulë që mund të vlerësohet nga ekspertë në bazë të % së konsumit mesatar apo të fuqisë të instaluar, sipas konsumit të energjisë.

2. Eficienta e energjisë – Të krijohet një mekanizëm nxitës që të suportojë kompanitë në blerjen e pajisjeve të reja teknologjike që kanë konsum të ulët të energjisë.

Z. Enea Karakaçi, MIE, u shpreh se ka kërkesë të vazhdueshme nga bizneset për rritjen e kapaciteteve për vetëprodhim dhe prodhim përmes paneleve diellore. Rrjeti aktual është i amortizuar edhe pse janë bërë investime të rëndësishme dhe ka limitime kapacitetesh. Megjithatë, po të bëjmë një krahasim në rajon, Shqipëria ka një nivel të lartë prej 500 kW (ndër më të lartit së bashku me Greqinë e Spanjën) pasi vendet e tjera janë 10-20 deri max. 200 kW. Kjo është bërë duke u bazuar në burimet tona natyrore e diellore. Një nga mekanizmat që është marrë në shqyrtim, ishte netimi vjetor i energjisë që tani ndoshta ka ardhur koha ta pranojmë si opsion.

Sa i përket investimeve në vetëprodhim, për ato që kanë konsum të lartë, sugjeroi që të mendohet instalimi i një impianti 5-7 MW dhe të bëjnë shkëmbime me kompani të tjera duke zgjeruar fushën e aktivitetit edhe në këtë drejtim. Së fundi, gjithë elementi bazë është investimi në eficientë e energjisë, por në 2022 fondi i caktuar në bashkëpunim me MFE shkoi në suport të konsumatorëve familjarë mbi nxitjen e vendosjes së paneleve. Aktualisht është aplikuar tek WBIF si mundësi përtej bankave që të jepet një grant që të lehtësojë mundësitë e financimit për matësit e eficientës.

Znj. Ekaterina Solovova, BERZH, në përgjigje të komenteve të disa prej anëtarëve të KI-së mbi mungesën e aksesit në financim për burimet e rinovueshme, inkurajoi shoqatat e biznesit, aktorët në treg dhe bizneset individuale që të kontaktojnë zyrën e BERZH-it apo institucionet e tjera ndërkombëtare financiare, bankat dhe donatorët, për informacion të përditësuar në lidhje me opsionet e financimit, në rast se një informacion i tillë mungon apo duket konfuz. Zyra e BERZH-it do të ishte e gatshme të jepte informacion të përditësuar (edhe përmes seminareve, nëse e nevojshme) në lidhje me programet e saj, llojet e financimit që ofrohen dhe çdo informacion tjetër rreth opsioneve të disponueshme. Nga ana tjetër, anëtarët e biznesit janë gjithashtu të mirëpritur të paraqesin çdo projekt specifik që mund të jetë me interes për BERZH-in. BERZH ofron financim të drejtpërdrejt, financim dhe ndarje të rrezikut përmes bankave tregtare, dhe gjithashtu mobilizon grante të donatorëve për investime dhe asistencë teknike për projekte individuale.

Dr Constantin Von Calvensleben, FIAA/Voltalia, falenderoi për mundësinë e pjesëmarrjes, në emër të FIAA. Voltalia Albania sh.p.k. filloi të operojë në Shqipëri në fund të 2020 pasi fitoi një tender të Qeverisë Shqiptare për energjinë diellore. Aktualisht, projekti më i madh në ndërtim i Voltalia-s është ai i ngritjes së impiantit diellor të Karavastasë me bashkëfinancim të BERZH-it dhe IFC i cili do i shpërndajë energji “green” KESH-it prej tetor 2023 me çmim të arsyeshëm. Voltalia ka fituar gjithashtu edhe projektin tjetër të “Parkut Diellor në Spitalë” me kapacitet 100 MW “peak” i cili është në fazë përgatitore. MIE ka mbështetur tranzicionin në energjinë “green”, por megjithatë ka ende disa fidat me të cilat përballen zhvilluesit e energjisë së rinovueshme:

1. Paqartësi apo problematika në titujt e pronësisë së tokës. Nevojitet të përmirësohet bashkëpunimi midis Agjencisë Shqiptare të Kadastrës dhe sipërmarrjes për zgjidhjen e problematikave të titujve të pronësisë të tokave që janë të domosdoshme për ngritjen e parqeve/impianteve. Ndërtimi i linjave të transmetimit dhe i kullave, mund të konsiderohet të bëhet në bazë *servitudi* sikurse bëhet në disa vende pasi kjo ofron avantazhin që kur linja të mos jetë më e nevojshme toka t’i kthehet pronarit (kështu mund të reduktohet rezistenca).
2. Shkurtimi i procesit të miratimit të lejeve të ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit, i cili aktualisht është tepër i gjatë dhe burokratik.
3. Shitja e energjisë mund të lehtësohet nëse ka lidhje ndërkombëtare inter-koneksioni me kapacitete të rritura, si p.sh. ajo me Greqinë. E rëndësishme është edhe linja me Maqedoninë e Veriut ku po punohet, por do duhej ngritur edhe një linjë në veri. Sa më shumë të shtohen këto linja e sa

më parë të përfundojnë, aq më mirë do ishte për bizneset duke i bërë edhe më lehtësisht të financueshme investimet.

4. Burimet alternative konsiderohen me ndërprerje të vazhdueshme nga natyra, pasi nëse era nuk fryn apo dielli nuk del, nuk prodhohet energji, ndaj ruajtja e energjisë është shumë e rëndësishme por aktualisht mungon kuadri ligjor mbi magazinimin me bateri të energjisë.
5. Toka bujqësore patjetër që është mjaft e rëndësishme për bujqësinë, por në disa zona jo pjellore për bujqësinë do ishte me interes nga ana e investitorëve prodhues të energjisë, që të lehtësohet transferimi i destinacionit të këtyre tokave nga bujqësore në toka për prodhim të energjisë.
6. Klima e mirë fiskale është gjithashtu shumë e rëndësishme. Janë bërë përpjekje në drejtim të kuadrit fiskal nga MIE dhe MFE, por do vlerësohej nëse merret në konsideratë nxitja përmes heqjes së TVSH së importit për pajisjet fotovoltaike si paneleve, transformatorëve, inverterave e pajisjeve të tjera.

Z. Enio Jaço, Amcham, theksoi se modernizimi dhe transferimi në burime alternative të energjisë, bashkon interesat e sektorit privat dhe të qeverisë. Toka është një problematikë që është akoma e paqartë se çfarë karakteristikash duhet të ketë një tokë që të konsiderohet për investime në energji. Rrjeti i shpërndarjes u diskutua që ka limitimet e veta. Incentivat ndonjëherë nuk janë të qarta apo nuk janë të harmonizuara me kërkesat e BE—një mundësi shumë e madhe për NVM-të për investime, por jo çdo incentivë është në favor të tyre. Katër rekomandimet e Amcham janë:

1. Kuadri ligjor për investimet në drejtim të energjisë së rinovueshme ka vend për përmirësime. Mbështetet fakti që një ligj i ri po propozohet.
2. Duben investime publike në rrjetin e shpërndarjes që t'u mundësojnë investitorëve të sektorit privat të kenë kapacitet më të lartë prodhues dhe të shesin në sistemin e shpërndarjes.
3. Më shumë incentiva fiskale për NVM-të përmes skemave mbështetëse sikurse ato të AZHBR-së që janë në linjë me direktivat e BE, por duhen edhe mjaft të tjera.
4. Rritje e rolit të dhomave e shoqatave të bizneseve, në konsultimet publike mbi kuadrin rregullator e ligjor në këtë drejtim pasi ato janë aktorët që mund të rrisin ndërgjegjësimin.

Z. Enea Karakaçi, MIE, u shpreh se pavarësisht ka një dëshirë për pjesëmarrje në konsultimin publik, kjo gjithashtu shoqërohet edhe me një ankesë të përgjithshme për moszhvillimin e konsultimit publik. Projektligji për burimet e rinovueshme ka qenë i publikuar në regjistrin elektronik të konsultimit publik për mbi 3 muaj, por interesi dhe komentet për të kanë qenë zero. Të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje shprehën interes për konsultimin publik, por shoqatat e biznesit nuk duket se janë shumë të fokusuar për t'u përfshirë në mënyrë aktive në këtë proces. Fakti është që për këtë konsultim, nuk ka patur asnjë angazhim direkt nga ndonjë subjekt.

Megjithatë, MIE është e hapur të diskutojë me palët e interesuar për gjetjen e një mekanizmi më të mirë për procesin e konsultimit publik, por ndërkohë edhe shoqatat të angazhohen në mënyrë që të mblidhen komente të vlefshme për përmirësimin e projekt-ligjeve.

Z. Nikolin Jaka, Dhoma Tregtisë Tiranë, falenderoi KI për punën hulumtuese për të përfshirë në një material të gjitha interesat e sipërmarrjes private. Fokusi sigurisht që kanë qenë NVM-të pasi edhe sipas analizës të DHTI TR rezulton se shumë pak kompani janë të përfshira në tensionin 35KW-110 KW- pra si konsumatorë të mëdhenj janë rreth 40 të tillë.

1. Kriza energjetike ka ndryshuar rregullat dhe ndoshta është momenti që të bëhet një analizë në lidhje me kostot dhe vlerësimin nëse fuqia e instaluar mund të rritet mbi 0,5 MW apo 1MW. Ideja është të mbështesim sipërmarrjen dhe të vlerësojmë mundësitë reale që imponohen nga situata aktuale. Vlerësohet mbështetja që MIE i ka dhënë sipërmarrjes gjatë vitit 2022. Iniciativa e shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë që në janar të 2022 u konkretizua në bashkëpunim me MIE për ngritjen e një grupi të përbashkët pune. Nga 7 kërkesa të komunitetit të biznesit, MIE

- pranoi 5. Një nga kërkesa e paplotësuar lidhet me rritjen e kapacitetit të fuqisë së instaluar nga vetëprodhuesit.
2. Nevojiten investime madhore në rrjetit të transmetimit. Duke vlerësuar grupion e punës dhe dashamirësinë e MIE, duhet të vlerësohet edhe gjendja e rrjetit të transmetimit dhe nevoja për investime të fokusuara. Gjithashtu, vlerësohet mbështetja e MFE në lidhje me propozimin e biznesit për të përjashtuar nga TVSH-ja makineritë dhe pajisjet që lidhen me investimet në fushën e energjisë së rinovueshme eolike apo diellore.
 3. Një pikëpyetje e madhe lidhet me shfrytëzimin real që vendi ynë ka për burimet e rinovueshme apo eficiencën e energjisë. MIE-MFE-KI-EBRD, të gjithë bashkë duhet të mendojmë për një strategji për mënyrën e zhvillimit dhe shfrytëzimit të BRE. Cili është fokusi i saj dhe ku duhet të fokusohemi? Koha ka treguar që biznesi në Shqipëri bëhet me tepër me nuhatje dhe me jo me laps. Vërehet në 2 vitet e fundit një rritje e interesit për të investuar në BRE e cila lidhet me rritjen e kërkesës për energji. Ne duhet të jemi të qartë për efektivitetin e këtyre investimeve që të mos na ndodhi edhe në këtë fushë, sikurse në vitet '90 që të gjithë u fokusuan në tregti, në '97 në ndërtim dhe pastaj me arrorë dhe ullinj. Rrezikohet që të bëhen shumë investime pa bërë njëkohësisht edhe optimizim e tyre në praktikë. Sipërmarrjet janë fokusuar aktualisht në blerjen e tokave me qëllim investimin në parqe energjetike, por aktualisht mungon një ligj që strukturon apo kanalizon këto investime, zonat e tyre të cilat maksimizojnë rendimentin dhe nuk dëmtojnë.
 4. Është pozitive që MIE po vendos në funksion bursën e energjisë, por duhet të shikojmë sa të trajnuar janë operatorët për të patur qasje tek bursa e energjisë dhe për t'u edukuar në lidhje me tregun e energjisë. KI mund të trajtojë në vijim energjinë në kuadër të ciklit të termave të tij.
 5. Një pyetje për EBRD: Sipas njohurive tona, në vendet e BE-së ka incentiva që jepen për investime të mëdha në fushën e energjisë që mbulojnë edhe 50% të financimeve të nevojshme për këto investime. A është koha që Shqipëria duhet të përfshihet në këto subvencione që jepen nga EBRD-BE? Nëse po, është koha që ministrinë të përfshihen dhe të strukturojnë këtë mbështetje dhe subvencionimin për sipërmarrjen.
 6. Lufra dhe Fix shprehën qartë kërkesat e sipërmarrjes. Kapaciteti aktual maksimal i fuqisë së instaluar prej 0,5 MW mbulon vetëm 15%-20% të kërkesave të sipërmarrjes për energji. Sa i takon skemave të mbështetjes dhe subvencioneve për familjarët kushtëzohet nga mënyra si janë ndërtuar dhe vendosur ato.
 7. Vlerësohet fakti që diskutohet të lejohet investime në një vend të ndryshëm nga konsumi. Por në këtë rast duhet të sqarohet se cilat do të jenë kostot e transmetimit.
 8. Biznesi i vogël por edhe i mesëm kanë si problematikë procedurën e marrjes së lejeve së ndërtimit për impiantet fotovoltaike për vetëprodhim. Shumica e debateve dhe ankesa lidhet me pengesat që hasen nëpër bashki në lidhje me këtë fakt.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se MIE ka dhënë ndihmë dhe zgjidhje në kohë reale të kërkesave të biznesit në kategori të ndryshme duke qenë edhe në një “debat konstruktiv” me MFE sa i takon masave mbështetëse, pasi duhet të konsiderohet edhe qëndrueshmërinë fiskale. MIE ka prej vitesh një strategji që po e zbaton në fushën e energjisë, e cila është ngadalësuar për kushtet objektive që po kalon ekonomia, por sidoqoftë në favor të biznesit. Fokusi i kësaj mbledhjeje duhet të jetë tek biznesi i vogël dhe i mesëm.

Z. Giordano Gorini, Confindustria Albania, ngriti problematikat e mëposhtme:

1. Problemi kryesor i identifikuar nga anëtarët e Confindustria është rrjeti i amortizuar i shpërndarjes. Paralelisht me rritjen e kapacitete të prodhimit, duhet të bëhen investime në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes. Shembuj pozitivë në Itali dhe vende të tjera të Europës tregojnë se aty ku ka një rrjet transmetimi dhe shpërndarjeje në gjendje për të thithur energjinë e prodhuar, burimet e prodhimit të energjive të rinovueshme nuk krijojnë problem për njëra-tjetrën. Ky është një element kyç për rritjen e kapacitetit nga fotovoltaikët dhe një kërkesë edhe për prodhuesit e HEC-eve dhe sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ka kabina në vende të

ndryshme në Shqipëri të cilat nuk janë në gjendje të përballojnë energjinë që i ngarkohet rrjetit. Në këtë pikëpamje nuk janë vlerë e shtuar investimet e bëra nga NVM-të apo nga sipërmarrjet e tjera për sa kohë që nuk absorbohen siç duhet nga rrjeti.

2. Një problematikë tjetër madhore lidhet edhe me paqëndrueshmërinë e rrjetit e cila dëmton edhe investimet ekzistuese sikurse ai i bërë nga grupi *Maccaferri*, i cili që të ketë qëndrueshmëri në prodhimin e energjisë prej 3MW duhet të ketë qëndrueshmëri të rrjetit, uljet dhe ngritjet e të cilit e dëmtojnë dhe kushtëzojnë kapacitetin e prodhimit.

Mbyllja e mbledhjes

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Ministria Ibrahimaj falenderoi pjesëmarrësit për interesin e lartë të përfshirjes në këtë tematikë dhe iu kërkoi anëtarëve të sjellin propozime konkrete në lidhje me temat që do të diskutohen gjatë 2023.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve/Ministre e Financave dhe Ekonomisë
2. Z. Reald Keta, Këshilltar për Energjinë, deleguar nga znj. Edona Bilali, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Znj. Klodiana Ajazi, Nënkryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
4. Z. Aleko Proko, Drejtor Ekzekutiv, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë
5. Z. Enio Jaço, President, AmCham Albania
6. Z. Bilal Kara, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi (ATTSO)
7. Z. Nesti Tarsha, Administrator, Fix Pro sh.p.k. (*ad-hoc*)
8. Z. Luis Ndreka, Administrator, Lufra (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
2. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese e Zyrës së IFC në Shqipëri
3. Znj. Ledia Muço, Këshilltare për Çështjet Ekonomike, deleguar nga z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së

Nuk morën pjesë:

1. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
2. Z. Sokol Nano, CEO, AIDA
3. Z. Emanuel Salinas, Menaxheri i Zyrës së Banka Botërore në Tiranë
4. Z. Ardian Lekaj, Kryetar, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës

Të ftuar të veçantë:

1. Z. Christoph Denk, Drejtor për Strategjitë dhe Delivrimin e Politikave, BERZH
2. Z. Patrik Meier, Zëvendës Kreu i Misionit të Ambasadës Zvicerane
3. Z. Enea Karakaçi, Drejtori i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Energjisë dhe Industrisë, MIE

Të ftuar të tjerë:

Ish anëtarë të biznesit në KI

1. Dr. Constantin Von Alvensleben, Anëtar, FIAA/Drejtor i Përgjithshëm, Voltalia Albania
2. Z. Giordano Gorini, Zëvendës President, Confindustria Albania
3. Znj. Gerta Bilali, Drejtore Ekzekutive, Confindustria Albania
4. Z Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata e Bankave (AAB)
5. Z. Bledar Mankollari, Drejtor Ekzekutiv, Dhoma Gjermane e Tregtisë (DIHA)
6. Znj. Mira Pogaçi, Drejtore Ekzekutive, Bashkimi Tregtar Shqiptar (BTSH)

Përfaqësues të tjerë

7. Z. Edvin Preçe, Kryetar, Shoqata Pro-Eksport Albania (PEA)
8. Z. Samir Shqarri, Kryetar, Dhoma Zviceriane e Tregtisë në Shqipëri (SWISSA)
9. Z. Agim Rrapaj, Kryetar, KASH
10. Znj. Albana Laknori, Sekretare e Përgjithshme, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
11. Z. Bashkim Sykja, Drejtor Kabineti, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
12. Z. Reinaldo Pipiria, Kryetar, Shoqata Shqiptare e Pasurive të Paluajtshme (NAREA)
13. Z. Artan Gjergji, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Tregtisë Electronike (AECA)
14. Z. Dritan Mezini, Kryetar, AITA
15. Znj. Edlira Muedini, Menxhere Projekti, RISIA Albania
16. Znj. Aida Lahi, Këshilltare për Çështje të Politikave Ekonomike dhe Tregtisë, Ambasada Mbretërisë së Hollandës në Shqipëri
17. Znj. Manjola Mumajesi, Analiste për Tregtinë, Italian Trade Agency (ICE)
18. Z. Bardhi Sejdarasi, Kryeredaktor për Ekonominë, RTSH
19. Z. Martin Serreqi, Zv/Dekan për Sipërmarrjen dhe Marrëdhënien me Publikun, FEUT
20. Z. Ledjon Shahini, Lektor, Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranë, FEUT
21. Z. Sokol Spahiu, Ekspert për Energjinë